

FAKTE TË
SHPEJTA
MBI GJININË
DHE
ARMËT E
ZJARRIT
NË
KOSOVË*

Zyra Qendrore e Evropës Lindore dhe Juglindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (SEESAC) është një iniciativë e përbashkët e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (KBR) e cila ka për qëllim forcimin e kapaciteteve kombëtare dhe rajonale për kontrollin dhe pakësimin e përhapjes dhe keqpërdorimit të armëve të vogla dhe të lehta, duke kontribuar kështu në rritjen e stabilitetit, të sigurisë dhe të zhvillimit në Evropën Juglindore dhe Lindore.

Botimi i “Fakte të shpejta mbi gjininë dhe armët e zjarrit në Kosovë” u mundësua me kontributin e Bashkimit Evropian, përmes Vendimit të Këshillit të BE-së (CFSP) 2016/2356 në mbështetje të veprimtarive të SEESAC për çarmatimin dhe kontrollin e armëve në Evropën Juglindore.

Për më shumë informacion, kontaktoni:

Menaxherin e projektit të SEESAC
Bulevar Zorana Dindića 64, 11000, Beograd, Serbi
Tel: +381 11 415 5300 Faks: +381 11 415 5359
www.seesac.org

Falënderime:

Dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë për Komisionin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (AVL) për mbështetjen thelbësore në mbledhjen e të dhënave, të cilat bënë të mundur këtë raport. Ky raport gjithashtu është pasuruar me kontributet dhe komentet e anëtarëve të ekipit të SEESAC Juliana Buzi dhe Teodora Zafiu.

Fakte të shpejta mbi gjininë dhe armët e zjarrit në Kosovë

Ky raport u hartua nga Dragan Božanić, Specialist i projektit të SEESAC për hulumtimet dhe çështjet gjinore. Dušan Đukić, konsulent i nivelit “junior”, ofroi mbështetje për hartimin e raportit. Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal apo të Bashkimit Evropian. Përcaktimet e përdorura dhe prezantimi i materialeve në këtë publikim nuk nënkuptojnë shprehjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim, të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal, ose të Bashkimit Evropian për sa i përket 1) statusit ligjor të secilit vend, territor ose zonë, ose të autoriteteve apo grupeve të tij të armatosura; ose 2) për vijëzimin e kufijve të tij.

Dizajni dhe paraqitja grafike: Vladimir Garboš

Garantimi i cilësisë së dizajnit: Marina Ileš

Printuar nga: Cicero

Tirazhi: 100 kopje

© SEESAC 2019 - Të gjitha të drejtat të rezervuara

FAKTE TË SHPEJTA MBI GJININË DHE ARMËT E ZJARRIT NË KOSOVË

★ *Për Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara, referencat për Kosovën duhet të kuptohen në kontekstin e Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit.*

Për Bashkimin Evropian, ky emërtim nuk paragjykon pozicionet mbi statusin, dhe është në përputhje me rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Rreth buletinit me fakte të shpejta

Buletini me fakte të shpejta mbi gjininë dhe armët e vogla dokumenton lidhjet e shumta ndërmjet gjinisë dhe armëve të vogla në Evropën Juglindore (EJL) dhe nënvizon rreziqet specifike me të cilat përballen gratë dhe burrat lidhur me përdorimin dhe keqpërdorimin e armëve të zjarrit.

Faktet e shpejta japin një panoramë të përgjithshme të të dhënave të ndara sipas seksit, lidhur me pronësinë, aksesin, kërkesën për armë zjarri dhe ndikimin e tyre te gratë dhe burrat, duke përfshirë keqpërdorimin e armëve të zjarrit në kontekstin e dhunës në familje dhe vetëvrasjes.

Nëpërmjet aksesit të përmirësuar në të dhënat e ndara sipas seksit, faktet e shpejta përpiqen të rrisin njohurinë dhe ndërgjegjësimin e profesionistëve dhe të publikut të gjerë rreth aspekteve tejet gjinore të armëve të vogla. Gjithashtu, informacionet i ofrojnë politikëbërësve në Kosovë një instrument të thjeshtë për hartimin e politikave të bazuara në fakte dhe integrimin e gjinisë në legjislaicionin dhe politikat për kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta.

Burimet e të dhënave

Të dhënat e paraqitura në faktet e shpejta janë marrë nga disa burime:


1. Anketimi për shpërndarjen dhe ndikimin: Në bashkëpunim me qeveritë në EJL, SEESAC mblodhi dhe analizoi të dhëna për të identifikuar tendencat në shpërndarjen e armëve të vogla (veçanërisht për sa i përket llojit, sasisë, zotërimit, shpërndarjes, tregtisë së ligjshme/jashtëligjshme, prodhimit dhe lëvizjes së armëve të vogla dhe të lehta) si dhe pasojat e keqpërdorimit të tyre te qytetarët në rajon, si te gratë po ashtu edhe te burrat. Të dhënat janë mbledhur për periudhën 2012-2016. Më përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe, të dhënat e paraqitura në këtë publikim i referohen këtij burimi.

2. Anketimi për perceptimin: Në nëntor dhe dhjetor të vitit 2017, SEESAC kreu një anketim online për perceptimin e publikut, për të kuptuar më mirë perceptimin publik rreth mbrojtjes dhe sigurisë, përdorimit dhe mbajtjes së armëve të zjarrit dhe ekspozimit ndaj dhunës me armë zjarri në EJL. Në total, 53 936 të intervistuar morën pjesë në anketimin online, në të gjithë Evropën Juglindore. 1307 të intervistuar plotësuan anketimin në Kosovë.


3. Platforma e monitorimit të dhunës me armë (AVMP): AVMP-ja monitoron incidentet me armë zjarri që kanë ndodhur në EJL që nga viti 2014. Të dhënat mblidhen çdo ditë duke përdorur artikujt e mediave lokale, motorët e kërkimit online dhe kur është e mundur, raportet e institucioneve publike për incidentet me armë zjarri. Për qëllime të kësaj analize, u analizuan 1103 incidente të raportuara, të shtrira në periudhën 1 janar 2014 deri më 31 dhjetor 2018.

GJETJET KRYESORE


- 99,9% e të gjithë armëve të zjarrit janë në pronësi të burrave ndërsa gratë zotërojnë vetëm 0,1% të armëve të zjarrit;
- Burrat përbëjnë shumicën dërrmuese të personelit të autorizuar për të mbajtur armë zjarri në sektorin e sigurisë;
- 37,3% e burrave dhe 24,3% e grave të anketuara në vitin 2017 do të zotëronin një armë;
- 54,6% e grave dhe 43,5% e burrave ndihen më pak të sigurt me një armë në shtëpi;
- 36,3% e burrave dhe 24,2% e grave kanë pasur një lloj përvoje personale direkte me armët;
- Burrat përbëjnë 92,1% të viktimave të vrasjeve me armë zjarri, ndërsa gratë përbëjnë 7,9% të viktimave;
- 47,8% e grave të vrara dhe 71,3% e burrave të vrarë janë vrarë me armë zjarri;
- Burrat përbëjnë 87,4% të personave që kanë pësuar lëndime të shkaktuara me armë zjarri ndërsa gratë 12,6%;
- 77,8% e personave të vrarë nga një anëtar i familjes, janë vrarë me armë zjarri;
- 71,4% e grave dhe 81,8% e burrave të vrarë nga një anëtar i familjes, janë vrarë me armë zjarri;
- Të gjitha gratë e vrara nga partneri intim, janë vrarë me armë zjarri;
- Keqpërdorimi i armëve të zjarrit në dhunën në familje është më fatal se në çdo lloj tjetër incidenti;
- Burrat kryen 99,6% të të gjithë veprave penale me armë zjarri, ndërsa gratë vetëm 0,4% të incidenteve;
- Burrat përbëjnë 95% të viktimave të vetëvrasjeve me armë zjarri, krahasuar me gratë që përbëjnë 5% të viktimave;
- 88,9% e grave dhe 18,9% e burrave të vrarë me armë zjarri janë vrarë në shtëpitë, apartamentet ose oborret e tyre;
- 43,3% e burrave dhe 11,1% e grave të vrara me armë zjarri janë vrarë në rrugë.



Personat e pajisur me leje për armë zjarri, sipas seksit, 2016



Aplikantët për leje të reja, sipas seksit dhe viti



Personeli i sektorit të sigurisë i autorizuar për të mbajtur armë zjarri, sipas seksit, 2016

8
• Gra • Burra

1 / PRONËSIA, AKSESI DHE KËRKESA PËR ARMË ZJARRI

MBAJTJA E ARMËVE NGA CIVILËT

Burrat zotërojnë **99,9%** të të gjithë armëve të zjarrit ndërsa gratë vetëm **0,1%**

Në vitin 2016, 38 821 burra dhe 23 gra ishin të pajisur me leje për armë zjarri.


Gjatë periudhës 2012-2016, burrat morën 99,5% të të gjitha lejeve, krahasuar me 0,5% të lejeve të marra nga gratë. Vetëm në vitin 2016, 3680 burra dhe 23 gra aplikuan për leje.

SEKTORI I SIGURISË


Burrat përbëjnë shumicën dërrmuese të personelit të autorizuar për të mbajtur armë zjarri në sektorin e sigurisë

Në vitin 2016, 877 gra dhe 6956 burra në forcat e policisë si dhe 22 gra dhe 492 gra në shërbimet korrigjuese, ishin të autorizuar për të mbajtur armë zjarri.

Në vitin 2016, i gjithë personeli i punësuar nga shoqëritë private të sigurisë, të autorizuar për të mbajtur armë zjarri ishin burra (31)



A do të mbanit një armë? - Po; sipas seksit dhe moshës, 2017
(Burimi: Anketimi për perceptimin)



A do të mbanit një armë? - Jo; sipas seksit dhe moshës, 2017
(Burimi: Anketimi për perceptimin)




SJELLJET DHE KËRKESA PËR ARMË ZJARRI

37,3% e burrave dhe **24,3%** e grave të anketuara në vitin 2017 do të zotëronin një armë

Gratë e moshës mbi 65 vjeç kanë më shumë gjasa të thonë se do të zotërojnë një armë. Përveç këtij përjashtimi të dukshëm, burrat përbëjnë shumicën e personave që do të zotëronin një armë.

Megjithatë, shumica e grave dhe burrave, përkatësisht **75,7%** dhe **62,7%**, nuk do të zotëronin një armë

Me përjashtim të atyre mbi 65 vjeç, shumica dërrmuese e grave në të gjitha grupmoshat nuk do të zotëronin armë, ndërsa shumica e të anketuarve që nuk do të zotëronin armë janë gratë e grupmoshës 55 deri në 64 vjeç (95,2%).



Pasja e një arme në shtëpi do t'ju bënte të ndiheshit më të sigurt apo më pak të sigurt?, sipas seksit, 2017
(Burimi: Anketimi për perceptimin)


Edhe pse **24,3%** e grave thanë se do të zotëronin një armë, ato përbënin vetëm **0,5%** të aplikanteve për leje të reja

54,6% e grave dhe **43,5%** e burrave ndihen më pak të sigurt me një armë në shtëpi

Gratë kanë shumë më tepër gjasa që të ndihen më pak të sigurta me një armë në shtëpi, ndërsa shumica e burrave besojnë se mbajtja e një arme në shtëpi rrit sigurinë e tyre.

Burrat e moshës 16 deri në 24 vjeç dhe mbi 65 vjeç kanë më tepër gjasa të ndihen më të sigurt me një armë në shtëpi (përkatësisht 62,3% dhe 60%), ndërsa gratë e moshës 25 deri në 34 vjeç kanë më tepër gjasa të ndihen më pak të sigurta me një armë në shtëpi (61,9%).


2 / PËRVOJA



Keni pasur përvojë me përdorimin e armës?, sipas seksit, 2017
(Burimi: Anketimi për perceptimin)

36,3% e burrave dhe **24,2%** e grave kanë pasur një lloj përvojë personale direkte me armët – kanë përdorur armë, u është drejtuar arma ose të dyja

Edhe pse ka dallime ndërmjet grave dhe burrave rreth përvojave me armë, ato janë veçanërisht të konsiderueshme në aspektin e përdorimit të armëve të zjarrit – 18,6% e burrave raportuan se kanë përdorur një armë, krahasuar me 8,7% të grave. Për sa i përket ekspozimit ndaj dhunës me armë, përvojat e grave dhe burrave konvergojnë në një pikë, pasi 13,2% të grave dhe 13,6% të burrave u është drejtuar një armë.



Vrasjet me armë zjarri përkundrejt totalit të vrasjeve, 2012-2016


• Armë zjarri
• Mjete të tjera

14

3 / VIKTIMAT

68,6% e të gjithë vrasjeve janë kryer me armë zjarri

Armët e zjarrit janë mjeti i zgjedhur që mbizotëron më së shumti në kryerjen e vrasjeve. Ndërmjet viteve 2012 dhe 2016, 140 nga 204 vrasje u kryen me armë zjarri.




Viktimat e vrasjeve me armë zjarri, sipas seksit, 2012-2016

• Gra • Burra

Burrat përbëjnë 92,1% të viktimave të vrasjeve me armë zjarri, ndërsa gratë përbëjnë 7,9% të viktimave

Nga viti 2012 deri në vitin 2016, 129 burra dhe 11 gra u vranë me armë zjarri.


Edhe pse burrat përbëjnë shumicën dërrmuese të viktimave të vrasjeve, vdekjet me armë zjarri janë të shpeshta si te gratë ashtu dhe te burrat. Nga viti 2012 deri në vitin 2016, 11 nga 23 gra dhe 129 nga 181 burra u vranë me armë zjarri.



Viktimat e vrasjeve me armë zjarri përkundrejt totalit të vrasjeve, sipas seksit, 2012-2016

• Gra • Burra


47,8% e grave dhe 71,3% e burrave të vrarë janë vrarë me armë zjarri



Viktimat e vrasjeve me armë zjarri, sipas seksit dhe moshës, 2012-2016

↑

Burrat e moshës 36 deri në 60 vjeç përbëjnë diçka më pak se gjysmën e të gjithë viktimave të vrasjeve, pasuar nga burrat e moshës 19 deri në 35 vjeç, me 27,9%. Ndër gratë e vrara, e njëjta grupmoshë ka më tepër gjasa që të jetë viktimë e keqpërdorimit të armëve të zjarrit.




Viktimat e plagosjeve me armë zjarri, sipas seksit, 2012-2016

• Gra • Burra **16**

Burrat përbëjnë 87,4% të viktimave që kanë pësuar lëndime të shkaktuara me armë zjarri ndërsa gratë 12,6%


Burrat kanë shumë më tepër gjasa se sa gratë që të pësojnë plagosje të shkaktuara me armë zjarri. Nga viti 2012 deri në vitin 2016, 49 gra dhe 341 burra u plagosën me armë zjarri.



Viktimat e plagosjeve me armë zjarri, sipas seksit dhe moshës, 2012-2016

Burrat e moshës 19 deri në 35 vjeç përbëjnë 48,2% të viktimave të plagosjeve me armë zjarri, pasuar nga burrat e moshës 36 deri në 60 vjeç.

Ndër gratë, ato të moshës 19 deri në 35 vjeç janë më të rrezikuara nga plagosjet me armë zjarri.




Vrasjet e anëtarëve të familjes përkundrejt vrasjeve të tjera, 2012-2016

• Viktimat e vrasjeve të anëtarëve të familjes
• Viktimat e vrasjeve të tjera

DHUNA NË FAMILJE


8,8% e të gjitha vrasjeve janë kryer nga një anëtar i familjes

Nga të 204 personat e vrarë në Kosovë gjatë periudhës 2012-2016, 18 prej tyre, 11 burra dhe 7 gra, u vranë nga një anëtar i familjes.



Vrasjet në familje përkundrejt totalit të vrasjeve, sipas seksit, 2012-2016

• Gra • Burra



Vrasjet nga partnerët intimë përkundrejt totalit të vrasjeve, sipas seksit 2012-2016


• Gra • Burra

Dhuna në familje prek si gratë ashtu dhe burrat, por gratë rrezikohen në mënyrë disproporcionale që të vriten nga një anëtar i familjes

Ndërkohë që burrat përbëjnë shumicën e viktimave të vrara nga një anëtar i familjes (11 nga 18), gratë janë proporcionalisht më të ekspozuara ndaj rrezikut të vrasjes nga një anëtar i familjes. Nga 23 gratë e vrara gjatë periudhës 2012-2016, 7 prej tyre u vranë nga një anëtar i familjes. E njëjta gjë vlen edhe për 11 nga 181 burrat e vrarë.

17,4% e të gjitha grave të vrara dhe 0,6% e të gjithë burrave të vrarë janë vrarë nga një partner intim

Gratë janë veçanërisht në rrezik nga vrasjet nga partneri intim. 5 nga 23 gra të vrara ndërmjet viteve 2012 dhe 2016, janë vrarë nga partneri i tyre intim. Në të njëjtën periudhë, vetëm 2 nga 181 burrat e vrarë, u vranë nga partneri i tyre intim.



Vrasjet e anëtarëve të familjes, sipas mjetit, 2012-2016

• Armë zjarri
• Mjete të tjera

Armët e zjarrit janë mjeti që përdoret më shpesh për kryerjen e vrasjeve të anëtarëve të familjes. 77,8% e personave të vrarë nga një anëtar i familjes, janë vrarë me armë zjarri

Armët e zjarrit janë mjeti që përdoret më shpesh për kryerjen e vrasjeve të anëtarëve të familjes.

14 nga 18 persona, 5 gra dhe 9 burra, të vrarë nga një anëtar i familjes, u vranë me armë zjarri ndërmjet viteve 2012-2016.



Vrasjet e anëtarëve të familjes, të kryera me armë zjarri, përkundrejt totalit të vrasjeve në familje, sipas seksit, 2012-2016

20


• Gira • Burra

71,4% e grave dhe 81,8% e burrave të vrarë nga një anëtar i familjes, u vranë me armë zjarri

Nga viti 2012 deri në vitin 2016, 5 nga 7 gra dhe 9 nga 11 burra u vranë nga një anëtar i familjes.

Të gjitha gratë e vrara nga partneri intim, janë vrarë me armë zjarri


4 nga 4 gratë e vrara nga partneri intim, janë vrarë me armë zjarri. E njëjta gjë vlen edhe për 1 nga 2 burrat e vrarë nga partneri intim.



Shpeshësia e pasojave fatale sipas llojit të incidentit, 2014-2018

Keqpërdorimi i armëve të zjarrit në dhunën në familje është më fatal se në çdo lloj tjetër incidenti

18,4% e incidenteve të dhunës në familje të kapura nga AVMP, ku janë përdorur armët, kanë rezultuar në pasojë fatale, krahasuar me 11,5% të incidenteve në kontekst kriminal.




Autorët e veprave penale me armë zjarri, sipas seksit, 2012-2016

• Gira • Burra


4 / AUTORËT

Burrat kryen 99,6% të të gjithë veprave penale me armë zjarri, ndërsa gratë vetëm 0,4% të incidenteve


Armët e zjarrit keqpërdoren kryesisht nga burrat. Nga 3337 veprat penale me armë zjarri të raportuara gjatë periudhës 2012- 2016, 3325 u kryen nga burrat dhe 12 nga gratë.



Autorët meshkuj të vrasjeve me armë zjarri, sipas moshës, 2012-2016



Marrëdhënia ndërmjet viktimës dhe autorit të incidenteve me armë zjarri, sipas seksit, 2014-2018 (Burimi: AVMP)



Viktimat e vetëvrasjeve me armë zjarri, sipas seksit

99,2% e vrasjeve me armë zjarri u kryen nga burrat dhe vetëm 0,8% nga gratë, përkatësisht 250 dhe 2 në numra absolutë


Shumica e autorëve të vrasjeve ishin burra të grupmoshës 19 deri në 35 vjeç, pasuar nga burrat e moshës 36 deri në 60 vjeç. Dy gratë e vetme që kryen vrasje me armë zjarri ishin të moshës 19 deri në 35 vjeç.

MARRËDHËNIA NDËRMJET VIKTIMËS DHE AUTORIT TË INCIDENTEVE ME ARMË ZJARRI


Gratë rrezikohen më tepër nga keqpërdorimi i armëve të zjarrit nga partnerët intimë dhe të panjohurit. Burrat rrezikohen kryesisht nga miqtë/të njohurit/fqinjët pasuar nga të panjohurit.

4 / VETËVRASJET


Burrat përbëjnë 95% të viktimave të vetëvrasjeve me armë zjarri ndërsa gratë 5% →



Burrat përbëjnë 99,9% të zotëruesve të armëve të zjarrit dhe kanë kryer 99,6% të veprave penale me armë zjarri. Gjithashtu, ata përbëjnë shumicën e viktimave të vrasjeve dhe plagosjeve me armë zjarri (88,7%), por proporcionalisht janë më shpesh autorë se sa viktimat të keqpërdorimit të armëve të zjarrit. Nga ana tjetër, gratë zotërojnë vetëm 0,1% të armëve të zjarrit, përbëjnë 0,4% të autoreve të veprave penale me armë zjarri dhe 11,3% të viktimave.



Viktimat e vetëvrasjeve me armë zjarri, sipas seksit dhe moshës, 2012-2016 ↑



Vendndodhja e vrasjeve me armë zjarri, sipas seksit, 2012-2016 ↑

→ Në periudhën 2012-2016, 57 burra dhe 3 gra kryen vetëvrasje me armë zjarri.

Burrat e moshës 36 deri në 60 vjeç kanë më shumë gjasa të kryejnë vetëvrasje me armë zjarri pasuar nga burrat e moshës 19 deri në 35 vjeç.

5 / KONTEKSTI I INCIDENTIT

88,9% e grave dhe **18,9%** e burrave të vrarë me armë zjarri janë vrarë në shtëpitë, apartamentet ose oborret e tyre

43,3% e burrave dhe **11,1%** e grave të vrara me armë zjarri janë vrarë në rrugë

CIP - Каталогизација у публикацији
Народна библиотека Србије, Београд

623.44:305-055.1/.2(497.115)"2012/2107"

BOŽANIĆ, Dragan, 1975-


Fakte të shpejta mbi gjininë dhe armët e zjarrit në Kosovë / [ky raport u hartua nga Dragan Božanić]. - Beograd : UNDP SEESAC, 2019 (Beograd : Cicero). - 27 str. : tabele, graf. prikazi ; 30 cm

Tiraž 100.

ISBN 978-86-7728-277-6

a) Оружје -- Родни аспект -- Косово и Метохија -- 2012-2017
-- Статистика б) Ватрено оружје -- Родни аспект -- Косово и
Метохија -- 2012-2017 -- Статистика

COBISS.SR-ID 281004044





*Empowered lives.
Resilient nations.*

South Eastern and Eastern Europe Clearinghouse
for the Control of Small Arms and Light Weapons (SEESAC)

Bulevar Zorana Đinđića 64, 11000 Belgrade, Serbia

Tel: +381 11 415 5300

Fax: +381 415 5499

E-mail: seesac@undp.org

www.seesac.org



*This project is funded by
the European Union*

Working within the framework of:



Regional Cooperation Council

#SaferRegion